

L I G J
Nr.7868, datë 12.10.1994

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7619, DATË 12.10.1992 “PËR
INSPEKTORATIN E KONTROLLIT TË PËRDORIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Në ligjin nr.7619, datë 12.10.1992, në nenin 2 fjalët “Ministri i Industrisë, Energjetikës dhe i Burimeve Minerare”, ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët “Drejtori Ekzekutiv i saj”.

Neni 2

Në shkronjën “a” të nenit 3 fjalët “nga ndërhyrjet e dëmtimet e kryera pa leje”, ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët “ndërhyrjet e kryera pa leje dhe dëmtimet”.

Në pikën “e” të nenit 3, fjalët “me pëlqimin e pronarit...”, zëvendësohen me fjalët “në prani të pronarit”.

Neni 3

Neni 6 ndryshohet si vijon:

“Cenimi ose dëmtimi i matësit të energjisë elektrike për qëllime përfitimi, kur ai ndodhet brenda banesës ose jashtë saj, sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e lidhur ndërmjet palëve, dhe lidhja e përdoruesit të energjisë elektrike me rrjetin elektrik para aparatit, kur këto shkelje nuk përbëjnë vepër penale, dënohen për kundërvajtje administrative me gjobë 2000 deri në 20000 lekë për përdoruesit familjarë dhe 5000 deri në 100000 lekë për përdoruesit e tjerë, si dhe me zhdëmtimin nga kundërvajtësit e dëmit të shkaktuar ndërmarrjes. Të drejtën e gjobës e kanë inspektorët e kontrollit të përdorimit të energjisë elektrike.

Gjopa përbën titull ekzekutiv.”

Neni 4

Neni 7 ndryshohet si vijon:

“Gjopa deri në 3000 lekë është e formës së prerë. Kundër vendimit të dënimit me gjopa nga 3000 deri në 10000 lekë bëhet ankimi me shkrim brenda 5 ditëve nga data e shpalljes së vendimit ose e njoftimit të tij te kryetari i degës së inspektoratit të kontrollit të përdorimit të energjisë elektrike në rreth, akti i të cilit është i formës së prerë.

Kundër vendimit të dënimit me gjobë mbi 10000 lekë bëhet ankimi me shkrim brenda 5 ditëve nga data e shpalljes së vendimit ose njoftimit të tij te kryetari i inspektoratit të kontrollit të përdorimit të energjisë elektrike, vendimi i të cilit është i formës së prerë.

Me shpalljen e vendimeve të gjopave të formës së prerë bëhet menjëherë ndërprerja e furnizimit me energji elektrike.”

Neni 5

Në nenin 8, paragrafi i tretë, ndryshohet si vijon:

“Të ardhurat nga gjopat kalojnë në masën 50 për qind në buxhetin e shtetit dhe diferencat në

llogarinë e Korporatës Energjetike Shqiptare, të cilat të përdoren për blerjen e pajisjeve për kontrollin e zbulimin e abuzimeve.”

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.948, datë 25.10.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha